



SHPJEGIME METODOLOGJIKE:

Turizmi paraqet shumë e raporteve dhe dukurive që dalin nga udhëtimi dhe qënrimi i turistëve në një vend, ku udhëtimi dhe qëndrimi i tillë nuk do të bazohet në banim të përhershëm dhe nëse me to nuk është e lidhur kryerja e ndonjë veprimtarie ekonomike.

Turizmi ndërkombëtar paraqet shumë të raporteve dhe dukurive që rezultojnë në momentin kur turisti kalon kufirin shtetëror dhe qëndron në vendin tjetër më së paku një natë për shkaqe pushimi, rekreimi apo ngjashëm.

Turist paraqet çdo person, i cili qëndron përkohësisht në një vend jashtë vendit të banimit të përhershëm dhe atje kalon më së paku një natë në objekt hotelier ose në ndonjë objekt tjetër akomodues.

Turist vendas paraqet person me vendbanim të përhershëm në Republikën e Maqedonisë, i cili qëndron përkohësisht në vend tjetër jashtë vendbanimit të përhershëm dhe kalon më së paku një natë në objekt hotelier ose në ndonjë objekt tjetër akomodues për turistët.

Turist i huaj paraqet person me vendbanim të përhershëm jashtë Republikës së Maqedonisë, i cili qëndron përkohësisht në Republikën e Maqedonisë dhe kalon më së paku një natë në objekt hotelier ose në objekt tjetër akomodues për turistët<sup>1</sup>.

**TË DHËNA STATISTIKORE**  
PËR NUMRIN E TURISTËVE DHE BUJTJEVE TË REALIZUARA NË KOMUNËN E STRUGËS  
PËR PERIUdhËN KOHORE JANAR-DHJETOR 2015

Në bazë të të dhënave statistikore<sup>2</sup>, numri i turistëve në vitin **2015** në Komunën e Strugës ka qëndruar gjithsej **64094** turistë, prej të cilëve **32013** janë turistë vendas, kurse numri i turistëve të huaj ka qenë **32081** turistë. Në vitin 2015 janë realizuar gjithsej **300791** bujtje, prej të cilave **187146** nga ana e turistëve vendas, kurse turistët e huaj kanë realizuar gjithsej **113645** bujtje.

**Tabela nr.1, Numri i turistëve dhe bujtjeve të realizuara në Komunën e Strugës për vitin 2015**

Numri i turistëve dhe bujtjeve të realizuara për vitin 2015	Turistë			Bujtje të realizuara		
	Gjithsej	Vendas	Të huaj	Gjithsej	Vendas	Të huaj
<b>Gjithsej</b>	<b>64 094</b>	<b>32 013</b>	<b>32 081</b>	<b>300 791</b>	<b>187 146</b>	<b>113 645</b>

Burimi: Enti Shtetëror Statistikor, Shkup, 2015

Sipas numrit të turistëve të huaj që kanë qëndruar në Strugë në vitin 2015, vendin e parë e kanë zënë turistët nga **Mbretësia e Holandës** me **8542** turistë, në vend të dytë **Republika e Turqisë** me **6724** turistë, kurse në vend të tretë është **Republika e Shqipërisë** me **2557** turistë. Nga gjithsej **32081** turistë të huaj, **17283** turistë (gjegjësisht **55.5%**) bëjnë pjesë nga shtetet e lartpërmendura. Sipas numrit të bujtjeve të realizuara, nga gjithsej **113645** bujtje, në vend të parë ka qenë **Mbretëria e Holandës** me **61131** bujtje, në vend të dytë **Republika e Turqisë** me **9821** bujtje, kurse në vend të tretë **Republika e Shqipërisë** me **4895** bujtje të realizuara. Shtetet që përmenden më lartë marrin pjesë me **66.7%** në numrin e përgjithshëm të bujtjeve të realizuara.

Në vazhdim të këtij teksti do të paraqiten të dhënat për turistët e huaj që më së shumti e kanë vizituar dhe kanë qëndruar në Komunën e Strugës në vitin 2015, në rangim prej dhjetë shteteve.

<sup>1</sup> Definicionet për turistin, turistin e vendit dhe turistin e huaj janë dhënë në bazë të shpjegimeve metodologjike që jep Enti Shtetëror Statistikor i Republikës së Maqedonisë me seli në Shkup (për informacione më të hollësishme kliko në uebfaqen e këtij enti: [www.stat.gov.mk](http://www.stat.gov.mk)).

<sup>2</sup> Enti Shtetëror Statistikor i Republikës së Maqedonisë, Të dhëna statistikore për Komunën e Strugës, Shkup, 2015, faqe 1.




**Tabela nr.2, Numri i turistëve të huaj dhe bujtjeve të realizuara në Komunën e Strugës për vitin 2015**

Rang	Shteti	Numri i turistëve	Rang	Shteti	Bujtje të realizuara
1.	Mbretëria e Holandës	8 542	1.	Mbretëria e Holandës	61 131
2.	Turqia	6 724	2.	Turqia	9 821
3.	Shqipëria	2 557	3.	Shqipëria	4 895
4.	Kosova	1 874	4.	Izraeli	3 624
5.	Greqia	1 817	5.	Kosova	3 519
6.	Bullgaria	1 260	6.	Greqia	3 443
7.	Polonia	1 239	7.	Polonia	3 024
8.	Slllovenia	723	8.	Bullgaria	2 228
9.	Austria	704	9.	Belgjika	2 213
10.	Izraeli	646	10.	Gjermania	1 704
<b>Gjithsej:</b>		<b>26 086</b>	<b>Gjithsej:</b>		<b>95 602</b>

Nga gjithsej 32081 turistë të huaj që kanë qëndruar në Strugë gjatë vitit 2015, mbi **81.3%** iu përkasin turistëve që vijnë nga dhjetë shtetet e lartpërmendur. Sa i përket bujtjeve të realizuara nga ana e turistëve të huaj, mbi **84.1%** të bujtjeve iu përkasin këtyre turistëve.

**Paraqitja grafike nr.1, Numri i turistëve sipas muajve të vitit 2015**



**Paraqitja grafike nr.2, Bujtje të realizuara sipas muajve të vitit 2015**

